



**HIB PETROL**

**HIB Petrol SH.P.K.**

Talinoc i Muhaxherëve p.n.

Ferizaj 70000, Kosovë

Tel.: +381 (038) 777 777; Mob.: +386 49 500 813

E-mail: [info@hibpetrol.com](mailto:info@hibpetrol.com)

## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI (për furnizim me Derivateve)**

E lidhur me datë; 02.07.2018 ndërmjet palëve;

“**Hib Petrol**” SH.P.K me NRB 70249534, NRF 600015376, me seli në Talinoc të Muhaxherëve Ferizaj, perfaqësuar ligjërisht nga Drejtori Gjeneral z. **Hysen Lajqi**, dhe

**Kuvendi Komunal Obiliqit respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë** përfaqësuar nga Drejtori z. **Ferit Hashani**.

Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë në mes palëve në fushën e bujqësisë, sipas kushteve të tregut dhe normave të besimit reciprok, për mbështetjen e fermerëve.

“Hib Petrol” SH.P.K., në takimin e mbajtur me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë, të dt: 02.07.2018, arrinë marrëveshje bashkëpunimi që ti furnizojë fermerët e Obiliqit në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, me Derivate, në bazë të kërkesës së fermerëve.

Në kuadër të kësaj marrëveshje Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë është zotuar ndaj “Hib Petrol” SH.P.K., të na përkrahë në mënyrë të vazhduar me listat e përditësuara të fermerëve, po ashtu jemi dakorduar që të jemi në kontakt të vazhduar për thellimin e bashkëpunimit reciprok në fushën e bujqësisë.

E gjithë kjo marrëveshje bashkëpunimi u arrit si rezultat i seriozitetit, përkushtimit dhe besimit të Kompanisë më të madhe në treg “Hib Petrol” SH.P.K., që ka Komuna e Obiliqit, por qëllimi i kësaj marrëveshje është edhe shtrirja e bashkëpunimit edhe në qytetet tjera të Republikës së Kosovës.

Sa për fillim jemi dakorduar me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë që ti mbështesim fermerët me 5 cent me lirë për litër se sa qmimi ditorë në pikën ku ata furnizohen.

Të gjithë fermerët që deshirojnë të përfitojnë nga zbritja e qmimit ditorë të tregut duhet të paraqesin numrin identifikues të fermerit (NIF) që janë të regjistruar në Drejtorinë e lartpërmendur si fermerë.

Marrëveshja e arritur është e dedikuar vetëm për mjete bujqësore që ka për qëllim punimin e tokave bujqësore.

Kjo Marrëveshje e arritur ndërmjet kompanisë “Hib Petrol” SH.P.K., dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe vlen në afat prej 1 (një) viti me të drejtë vazhdimi, çdo ndryshim i marrëveshjes do të jetë me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

**Hib Petrol SH.P.K**



(Emri, mbiemri, nënshkrimi dhe vula)

**Komuna Obiliqit  
Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë**



(Emri, mbiemri, nënshkrimi dhe vula)